

PROCESVERBAL
nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 04.04.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmët nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Gorjan Sheqerinov, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 15-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski njoftoi se do të bëjë ndryshim në propozimin e rendit të ditës, me ç'rast pika "Të ndryshme" me titull "Propozim-vendim për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup" do të zhvendoset si Pika 3. Rrjedhimisht, të gjitha pikat në vijim do të zhvendosen një vend lart.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si mëposhtë:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbali të seancës së 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.03.2025.
2. Propozimet për iniciimin e procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV të transmetuesve.
3. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës - RADIO UNIVERSITETORE UGD FM nga Shtipi, për shkëlje të nenit 67 paragrafi (6) të LSHMAAV.

5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik- mallra: Modernizimi i server sallës.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Sigurim shëndetësor privat.
7. Propozim -vendim për përvetësimin e telefoni celular zyrtar.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Jançeski miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 26.03.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Petrusevski sqaroi se në kuadër të kësaj pike do të propozohen dy iniciativa për iniciimin e procedurave për heqjen e lejes për transmetim televiziv të transmetuesve. Ai theksoi se propozimi për TV Klan do të plotësohet, duke qenë se është dorëzuar material i ri që mundëson iniciimin e procedurës në bazë tjetër në pajtim me Ligjin. Ai propozoi një shpjegim hyrës dhe diskutim të përbashkët për dy propozimet, dhe më pas votim të veçantë për secilin prej tyre.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Z. Trajçevski sqaroi se dy transmetuesit, TV Klan dhe TV Sonce, në afatin e parashikuar Ligjor prej 30 ditësh nuk kanë paguar kompensim, që sipas Ligjit paraqet bazë për fillimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim. Plotësuese informoi se dje është njoftuar se në Televizionin Klan është regjistruar zvogëlim i numrit të punonjësve, që do të thotë se nuk plotësohen kuhtet minimale kadrovike të nevojshme për posedimin e lejes për të kryer veprimtari transmetimi. Në bazë të asaj ankese, Agjencia ka kontaktuar Agjencinë e Punësimit, nga e cila është marrë shkresë zyrtare. Ky dokument, menjëherë para fillimit të seancës, iu dorëzua anëtarëve të Këshillit si shtojcë e materialeve. Sipas të dhënave në shkresë, numri i punonjësve në TV Klan është 18 persona, që është nën minimumin ligjor prej 20 punonjësish. Prandaj, propozimi për fillimin e procedurës për heqjen e lejes të TV Klan, fillimisht bazuar për shkak të mospagesës së kompensimit, do të zgjerohet për të përfshirë arsyetimin se transmetuesi nuk plotëson kushtet minimale kadrovike, të përcaktuara nga mbikëqyrja administrative. Në lidhje me TV Sonce, si bazë për propozimin për heqjen e lejes mbetet vetëm mospagesa e kompensimit vjetor.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport-import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017, për mospërmbushje të detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0086, datë 28.02.2025, dhe në përputhje me Raportin me shkrim për mbikëqyrje të jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare mbikëqyrje administrative nr.03-1628/1, datë 04.04.2025, ku është konstatuar se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të nenit 21 të

Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe neni 62, paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk respekton Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, Këshilli në Agjencia në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport - import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141, datë 18.03.2019, për mospërbushje të detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0084 datë 25.02.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE SHPKNJP, Prilep, PA1 nr.08-141, datë 18.03.2019, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

Pika 3

Z. Trajčevski shpjegoi Vendimin e propozuar për anulimin e vendimit të mëparshëm për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup. Ai theksoi se edhe pse leja është hequr, Televizioni Shutel në afatin e përcaktuar ligjor ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative, ka paguar kompensimin e lejes, si dhe të gjitha shpenzimet tjera – përfshirë dhe shpenzimet për publikimin e vendimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në dy gazeta ditore. Gjithashtu, informoi se dje televizioni ka pasur problem teknik me operatorin A1, i cili duhet ta transmetojë përmes multipleksit. Për shkak të borxheve ndaj operatorit, A1 ka refuzuar sërish t'i përfshij në sistem. Prandaj TV Shutel ka kërkuar që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës së seancës dhe t'u kthehen mjetet e paguara, pasi nuk kanë mundur të vazhdojnë punën. Mirëpo, menjëherë para seancës, përmes telefonit e kanë njoftuar z. Trajčevski se i kanë rregulluar marrëdhëniet me operatorin A1 dhe se do të vazhdojnë me punë, prandaj kanë kërkuar që kjo pikë të mbetet në rend dite.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55, datë 03.03.2025 të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për heqjen e lejes për transmetim televiziv të shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-18, datë 07.09.2023, duke qenë se transmetuesi ka mënjeluar plotësisht shkakun për të cilën Këshilli i Agjencisë ka miratuar vendimin në fjalë, përkatësisht më 02.04.2025 në tërësi ka përmbushur detyrimet financiare ndaj Agjencisë, përkatësisht:

- ka paguar Faturën nr.2025-100-0011 datë 10.01.2025. (nr ynë.ark.05-137/1, datë 10.01.2025) për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv për periudhën nga

05.01.2025. deri më 04.01.2026, në shumë prej 1.240.182,00 (një milion e dyqind e dyzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë;

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 3.268,00 (tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) denarë, me TVSH, për publikimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr. 51/25 – sipas Faturës nr.2320-6849/27 datë 10.03.2025 (nr ynë.ark. 05-1106/1 datë 19.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në shumë të përgjithëshme prej 23.714,00 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e katërbëdhjetë) denarë me TVSH për publikimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në RMV-së (sipas Faturës së Veçer Pres SHPKNJP Shkup nr.2510300321 datë 05.03.2025. (nr ynë.ark.05-1166/1 datë 21.03.2025) dhe Faturën në Koha Produksion SHPK Shkup nr.36136/2025 datë 18.03.2025 (nr ynë.ark 05-1167/1 datë 21.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 1.083,00 (një mijë e tetëdhjetë e tre) denarë, me TVSH, për publikimin e Akvendimit për fshirje nga regjistri i transmetuesve PA1 nr.08-83 datë 07.03.2025, në Gazetën Zyrtare të RMV-së, nr.56/25 - sipas Faturës nr. 2617-6849/27 datë 14.03.2025 (nr ynë.ark.05-1241/1 datë 24.03.2025);

- ka paguar shpenzimet në shumë prej 3.268,00 (tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) denarë me TVSH për publikimin e këtij Vendimi për anulimin e vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023, në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, jo më vonë se 11.04.2025 të tërheqë Padinë e parashtruar në Gjykatën Administrative të RMV-së, më 02.04.2025 kundër Agjencisë, për anulimin e Vendimit PA1 nr.08-55 datë 03.03.2025 për heqjen e lejes, PA1 nr.08-18 datë 07.09.2023.

Vendimi hyn në fuqi me datë 11.04.2025, me kusht që Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, jo më vonë se data 11.04.2025. të tërheqë Padinë dhe të dorëzojë dëshmi në Agjencion.

Nëse transmetuesi, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nuk e përmbush obligimin brenda afatit të caktuar, mbetet në fuqi Vendimi i Këshillit të Agjencisë për heqjen e lejes për transmetim televiziv, Pa1 nr.08-55, datë 03.03.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikon në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik, pas hyrjes në fuqi të Vendimit të lartpërmendur, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, të regjistrohet në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 4

Z. Trajčevski, në lidhje me Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës - Radio Universitare UGD FM nga Shtipi, për shkak të shkeljes së nenit 67 paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,

informoi se gjatë ditës së djeshme është mbajtur takim me përfaqësuesit e radios. Po ashtu, në orët e mbrëmjes është njoftuar se Këshilli i Universitetit të Shtipit ka marrë vendim për kthimin e lejes për transmetim. Në këtë drejtim z.Trajçevski theksoi se pritet që Universiteti të dorëzojë deklaratë të noterizuar nga rektori, me qëllim që ky radiostacion jofitimprurës të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska, informoi se gjatë mbikëqyrjes së rregullt programore të kryer në dhjetor të vitit të kaluar, është konstatuar se radio UGD FM nuk transmeton përmbajtje programore të dizajnuara në mënyrë editoriale, por ekskluzivisht muzikë dhe njoftime vetëpromovuese. Ky konstatim ngriti dyshime se radio nuk e përmbush konceptin programor në përputhje me lejen. Prandaj, në periudhën prej 10 deri më 16 shkurt të këtij viti, Sektori ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore me analizë të të gjithë programit javor të transmetimit. Mbikëqyrja vërtetoi dyshimet – radio gjatë periudhës së analizuar nuk ka transmetuar program me përmbajtje të rregullt editoriale, por vetëm muzikë dhe afërsisht 6 orë njoftime vetëpromovuese. Në bazë të këtyre hulumtimeve, propozohet që radios t'i shqiptohet masë vërejtje publike, me afat prej 20 ditësh për të përmbushur detyrimet ligjore. Nëse radio nuk e kthen lejen dhe vendos të vazhdojë me punë, pas skadimit të afatit, do të realizohet mbikëqyrje kontrolli për të parë nëse kanë respektuar Ligjin.

Z. Fidanoski tha se duke pasur parasysh njoftimin e drejtorit se kjo radio jofitimprurëse ka për qëllim ta kthejë lejen, pyeti nëse gjatë bisedës janë treguar arsyet apo motivet për këtë vendim?

Udhëheqësja Janevska sqaroi se në periudhën e kaluar kanë pasur komunikim me përfaqësues të Radios Universitare UGD FM përmes e-mail dhe bisedave telefonike. Ajo theksoi se është sugjeruar që nëse nuk mund t'i përmbushin obligimet e parapara në konceptin programor, të kërkojnë ndryshim zyrtar të konceptit nga Këshilli i Agjencisë. Në këtë drejtim, u është shpjeguar se cilat pjesë të konceptit programor janë subjekt i ndryshimeve dhe cilat jo, me propozim konkret që të zvogëlohet vëllimi i totalit të programit që transmetohet në bazë ditore. Aktualisht radio transmeton program 24 orë në ditë, që nënkupton rritjen e detyrimeve për prodhimin e programit të saj. Megjithatë, nëse bien dakord për uljen e volumit, sipas rregullativës ligjore për transmetuesit jofitimprurës, lejohet transmetim minimal gjatë ditës prej 4 orë, që do të nënkuptonte edhe ulje të detyrimeve. Përgjigja fillestare prej tyre ishte se ata nuk kishin mjaftueshëm studentë për prodhimin e programit të tyre. Mirëpo, në bisedën e djeshme u theksua se besojnë se nuk kanë publik, por radioja ndiqet kryesisht online. Prandaj, ata e konsiderojnë të padobishme investimin në transmetim teritorial dhe synojnë ta mbajnë programin ekskluzivisht në formë online.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me Shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare, mbikëqyrje programore, nr.10-963/1 datë 10.03.2025 dhe njëzëri konstatoi që Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës - RADIO UNIVERSITARE UGD FM nga Shtipi, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 67, paragrafit (6) të LSHMAAV, sepse në javën prej 10 deri më 16 shkurt 2025 transmetuesi nuk ka realizuar së paku 80% të konceptit programor për të cilën është dhënë leja për veprimtari radiodifuzive.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022,

urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizon punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përpiloi Akvnendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Modernizimi i server sallës. Ajo theksoi se qëllimi i këtij furnizimi është përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë të server-sallës të Agjencisë. Furnizimi është paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik të Agjencisë, ndërsa mjetet financiare janë siguruar në Planin financiar për vitin 2025. Sipas vlerës së parashikuar, procedura do të zbatohet si furnizim publik me vlerë të ulët, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik që kanë të bëjnë me këtë lloj procedurash. Do të fillojë me publikimin e njoftimi përmes sistemit elektronik për furnizim publik (SEFP). Të gjitha të dhënat dhe detajet përkatëse në lidhje me këtë procedurë gjenden në materialet e dorëzuara për seancën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: Modernizimi i server sallës.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Modernizimi i server sallës, parashihet dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Sigurim shëndetësor privat. Ajo informoi se ky furnizim është paraparë në Planin Vjetor për furnizime publike të Agjencisë, ndërsa mjetet financiare për realizimin e saj sigurohen nga Plani Financiar për vitin 2025. Procedura do të realizohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, në përputhje me shumën e vlerës së parashikuar, duke respektuar plotësisht dispozitat e Ligjit për furnizim publik që kanë të bëjnë me këtë lloj procedurash. Do të fillojë me publikimin e shpalljes përmes sistemit elektronik të furnizimit publik (SEFP), si dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Të gjitha informacionet dhe detajet shpesh gjenden në materialet e ofruara për seancën.

Z. Fidanoski , në bazë të materialeve të dorëzuara, ka vërejtur se bëhet fjalë për numër të kufizuar të personave të siguruar, gjegjësisht 15 persona dhe kërkoi sqarim më të detajuar lidhur me këtë pikë.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se këta 15 persona nga Shërbimi Profesional vullnetarisht janë regjistruar si të interesuar për shfrytëzimin e këtij shërbimi.

Z. Fidanoski pyeti nëse në këtë rast këta persona do ta ruajnë të drejtën për sigurim të rregullt shëndetësor që tashmë e kanë, për çka udhëheqësja është përgjigjur pozitivisht.

Z. Petrushevski pyeti nëse do të shfrytëzohen mjetet nga buxheti i Agjencisë për mbulimin e shpenzimeve për 15 personat e propozuar, si dhe nëse ka bazë ligjore për realizimin e këtij furnizimi publik ?

Udhëheqësja Mitrevska u përgjigj se për këtë furnizim ka bazë ligjore, duke qenë se tashmë shumë institucione të tjera e zbatojnë dhe e praktikojnë këtë shërbim. Ajo tregoi se për furnizimin kanë aplikuar 15 persona, ndërsa shpenzimet do të ndahen: gjysmën do t'i mbulojë Agjencia dhe gjysmën punonjësit që kanë aplikuar.

Z. Petrusevski vuri në dukje se materialet e dorëzuara nuk ofrojnë informata konkrete sipas cilit nen të Ligjit propozohet dhe zbatohet ky furnizim publik për sigurim shëndetësor privat dhe kërkoi informata shtesë.

Z. Trajçevski shpjegoi se ky furnizim publik buron nga Marrëveshja Kolektive e nënshkruar, e cila parasheh që Agjencia të mbulojë 50% të shpenzimeve për sigurim shëndetësor privat të punëtorëve të interesuar, ndërsa 50% të tjera do t'i mbulojnë vetë punëtorët. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 15 persona kanë shprehur interesim për sigurim shtesë shëndetësor.

Z. Fidanoski pyeti se si do të shpenzohen mjetet për furnizimin publik, gjegjësisht nëse do të përdoren sipas nevojës.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se mjetet do të shpenzohen vetëm për ata punëtorë që do të apikojnë për shfrytëzimin e shërbimit. Furnizimi do të kryhet përmes përzgjedhjes së një operatori ekonomik i cili do të ofrojë kushtet më të favorshme në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe specifikimet teknike.

Z. Petrusevski pyeti nëse ka dëshmi se punëtorët që nuk kanë aplikuar nuk duan të shfrytëzojnë sigurimin shëndetësor privat?

Udhëheqësja Mitrevska u përgjigj se të gjithë të punësuarit në Shërbimin Profesional ishin informuar dhe kishin mundësi të barabarta për të aplikuar. Janë mbajtur takime me kompanitë e sigurimit, të cilëve u është shpjeguar se çfarë përfshin siguri shëndetësor privat dhe cilat janë të drejtat që rrjedhin prej tij. Të gjithë punonjësit ishin të njoftuar për mundësitë, por vetëm 15 persona vendosën të përfitonin nga ky opsion.

Z. Petrusevski shprehu habinë që nga gjithsej 60 punëtorë, vetëm 15 kanë aplikuar për sigurim shëndetësor privat. Ai gjithashtu vërejtë se në materialet janë cekur të dhënat personale të punonjësve, respektivisht vitet e tyre të lindjes.

Z. Trajçev pyeti nëse Agjencia si institucion është ligjërish e obliguar që të zbatojë procedurë të tillë, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për shpenzime të mjeteve buxhetore?

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe këshillit, Shef kabineti, mr.Dragica Ljubevska sqaroi se kryetari i Sindikatës së Agjencisë disa herë ka dërguar

përmes postës elektronike të gjithë punëtorëve, pavarësisht nëse janë anëtarë të sindikatës, për tu shprehur për sigurimin shtesë shëndetësor. Kjo e drejtë buron nga Marrëveshja Kolektive e Agjencisë, e cila jep të drejta më të mëdha se ligji, dhe është ligjërish e qëndrueshme dhe e ligjshme. Në lidhje me pyetjen e z. Fidanoski për mënyrën e pagesës së premisë, ajo informoi se paguhet një shumë mujore, ku 50% e premisë mbulohet nga Agjencia, ndërsa 50% e paguan punëtori.

Z. Petrushevski pyeti nëse kjo është një pagesë fikse, pavarësisht nëse punonjësi ka nevojë për trajtim?

Udhëheqësja Ljubevska u përgjigj se kjo është kështu, me përjashtim që nëse dikush ka nevojë do t'i shfrytëzojë shumat e shënuara në pako, siç janë definuar në vetë specifikimin dhe kontratën që do të lidhet me kompaninë e përzgjedhur të sigurimit. Për sa i përket moshës së punonjësve, ajo sqaroi se janë mbajtur prezantime dhe kontakte me disa kompani sigurimesh, por asnjëra prej tyre nuk ka mundur të bëjë ofertë pa marrë parasysh moshën e punonjësve. Mosha është një element i rëndësishëm për kompanitë, sepse në bazë të saj vlerësohet se çfarë çmimi do të ofrojnë dhe cilat paketa shëndetësore do të përfshihen.

Z. Fidanoski u pajtua dhe theksoi se çdo kompani siguri para se të bëjë ofertë duhet të dijë moshën e të punësuarve dhe nëse kanë sëmundje kronike. Kjo ndikon në masën e premisë, pasi sipas kritereve të tyre, mund ta rrisin ose ulin. Ai edhe njëherë ka kërkuar konfirmim se pagesa do të ndahet 50% nga Agjencia, 50% nga punonjësi, për të cilën ka marrë një përgjigje të konfirmuar nga shërbimi.

Z. Petrusevski ka vërejtur se bëhet fjalë për shumë prej 1.100.000 denarë, që është pak më pak se 20.000 euro.

Z. Trajčevski sqaroi se e gjithë shuma prej 1.100.000 denarë do t'i paguhet në tërësi kompanisë së përzgjedhur të sigurimeve, por më pas 50% nga ajo shumë do të paguajnë punëtorët. Kjo do të thotë se Agjencia në maksimum do të paguajë shumë prej 550.000 denarë.

Këshilli i Agjencisë, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga znj. Mashoviq, dha miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Sigurim shëndetësor privat.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Sigurim shëndetësor privat, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 7

Z. Trajčevski shpjegoi Propozim-vendimin për përvetësimin e telefoni celular zyrtar. Ai shpjegoi se personi i cekur në Kërkesë, një muaj më parë ishte punësuar në një institucion tjetër shtetëror si drejtor i njëres prej firmave të revizionit. Ai ka kërkuar që ta mbajë celularin që deri atëherë e ka shfrytëzuar si zyrtar, derisa ishte i punësuar në Agjenci. Ai gjithashtu sqaroi se në pajtim me Ligjin, para se të jepet pëlqimi apo miratimi për përvetësimin e telefoni celular zyrtar, Këshilli duhet ta miratojë këtë propozim, ku punonjësi duhet të paguajë vlerë kontabël të celularit në Agjenci, sipas vlerësimit të kryer.

Z. Petrushevski shprehu përkrahje për propozimin, duke theksuar se kemi të bëjmë me shumë të vogël, por në të njëjtën kohë theksoi se celulari i përdorur nga punonjësi deri më tani përmban të dhëna personale dhe të tjera të përdoruesit.

Z. Trajçev, edhe pse është pajtuar që shuma është e vogël, ka theksuar se në parim nuk pajtohet me këtë mënyrë të përvetësimit të pronës që është në pronësi të Agjencisë. Ai ritheksoi se këtë e kishte theksuar edhe në të kaluarën kur janë marrë vendime të ngjashme, sepse mendon se për procedura të tilla duhet të ekzistojnë një lloj ankandi për të përcaktuar vlerën e vërtetë në treg, jo vetëm vlerën kontabël. Dhe për këtë arsye ai deklaroi se nuk e mbështet propozimin.

Z. Trajçevski sqaroi se nëse personi që kërkon telefon celular do të ishte ende i punësuar në Agjenci, telefonin do ta merrte falas. Ai theksoi se vlera e këtyre pajisjeve bie ndjeshëm me kalimin e kohës, dhe telefoni tashmë është i vjetër gati 2 vjet. Agjencia nuk ka ku ta shesë dhe nuk ka blerës, ndaj e konsideron situatën joefikase. Ai tha se do të ishte mirë nëse dhe punonjësit e tjerë do të kërkonin t'i blinin telefonat, në vend që të ruheshin dhe të shndërroheshin në mbeturina elektronike. Ai theksoi se pas 2-3 muajsh do të shpenzohen dhe nëse në përputhje me Rregulloren për përdorimin e celularëve zyrtarë, punonjësit nuk i mbajnë ato, do të përfundojnë në bodrumin e Agjencisë pa asnjë vlerë përdorimi dhe vlerë financiare.

Z. Fidanoski theksoi, me sa di unë, telefoni celular që kërkohet të përvetësohet është marrë si subvencion përmes marrëveshjes me kompaninë, që do të thotë se Agjencia nuk e ka paguar me para reale. Telefonat celularë të punonjësve të Agjencisë, siç ka theksuar, janë marrë me subvencion.

Z. Trajçevski konfirmoi se kjo është e vërtetë.

Z. Petrushevski tha se kjo është një tjetër dëshmi që konfirmon qëndrimin e tij se do ta mbështesë propozimin.

Këshilli i Agjencisë me 4 vota "pro" dhe dy abstenime nga z. Trajçev dhe z. Jançeski, dha miratim që Drejtori i Agjencisë të miratojë Vendim për përvetësimin e telefonit celular zyrtar të markës " Samsung Galaxy A54 5G", me numër inventari 3104, personit të punësuar më parë në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në vendin e punës Udhëheqës i Shërbimit për Revizion të Brendshëm, i cili ishte përgjegjës dhe e përdorte atë, për mbajtjen e pajisjes nga ana e tij.

Personi në fjalë në afat prej 3 (tri) ditësh nga pranimi i vendimit, në llogarinë denarë të Agjencis nr.300000000618023 në Bankën Komerciale SHA Shkup të kryen pagesën në shumë prej 5.488,00 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) denarë, që paraqet vlerën kontabël të pajisjes në këtë moment, gjegjësisht diferencën në përputhje me zhvlerësimin e përcaktuar të celularit zyrtar të pranuar me subvencion.

Pas pagesës së shumës dhe dorëzimit tek personi i caktuar, telefoni celular zyrtar do të fshihet nga evidenca kontabël e Agjencisë.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**